VENDIM
Nr. 190, datë 12.8.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGOVIA.ALBANIA" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 30.1.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "d", dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", 13 dhe 14, pika 9 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.8.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1693/15 prot., datë 7.8.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Energovia.Albania' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 113, datë 3.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Energovia.Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në median e shkruar më datat 4.6.2025 dhe 5.6.2025, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të përcaktuar për paraqitjen e komenteve apo objeksioneve (deri më 13.6.2025), nuk u paraqit asnjë koment.
- ERE, me shkresën nr. 1693/7 prot., datë 5.6.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Kjo shkresë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj më 11.6.2025 iu dërgua shoqërisë nëpërmjet e-mail-it një kopje e skanuar.
- Në përgjigje, me e-mail-in e datës 20.6.2025, shoqëria depozitoi pjesërisht dokumentacionin e munguar, duke njoftuar se vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratorin do ta sillte sapo të pajisej me të dhe të përkthehej. Po atë ditë, ky dokumentacion u depozitua edhe fizikisht në protokollin e ERE-s me nr. 1693/9 prot., datë 20.6.2025.
- Për sa më sipër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 136, datë 7.7.2025, është vendosur zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s deri në 30 (tridhjetë) ditë për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke i lënë detyrë shoqërisë që brenda 20 (njëzet) ditëve të depozitojë në ERE vërtetimin për gjendjen gjyqësore të administratorit të saj.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, me shkresën nr. 1693/11 prot., datë 9.7.2025, shkresë, e cila është kthyer sërish mbrapsht nga shërbimi postar, ndaj i është dërguar shoqërisë një kopje e skanuar me e-mail-in e datës 15.7.2025.
- Me e-mail-in e datës 16.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/12 prot., datë 16.7.2025, shoqëria ka përditësuar adresën e saj dhe ka njoftuar për të depozituar brenda afatit dokumentin e munguar.

- Me e-mail-in e datës 28.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1693/13 prot., datë 28.7.2025, dhe së fundi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1691/14 prot., datë 4.8.2025, shoqëria ka depozituar në ERE-dëshminë e penalitetit të administratorit në format origjinal.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c"; si dhe pikën 2.5.

- Vlefshmëria kontratave të shërbimit për stafin teknik (shërbime ligjore dhe të kontabilitetit) nuk mbulon të gjithë afatin 5-vjeçar të licencës, ndaj brenda afatit të përfundimit të tyre, pra brenda datës 1.2.2026 shoqëria duhet që të depozitojë kontratat e rinovuara për shërbimet e jashtme, ose çdo dokument tjetër në lidhje me disponimin e stafit teknik.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të zbatuar në vijim edhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Energovia.Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shfuqizuar.

3. *Shfuqizuar.*

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Energovia.Albania" sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTAR I BORDIT TË ERE-s
Petraq Lika